

FINANCA

BULETINI MUJOR | TETOR 2025



MINISTRI I FINANCAVE MERR PJESË NË TAKIMET VJETORE TË FMN DHE GRUPIT TË BB

Ministri Petrit Malaj mori pjesë në Takimet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtare dhe Grupit të Bankës Botërore, të cilat u zhvilluan në data 16-18 Tetor 2025, në Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutimi në nivel ndërkombëtar i zhvillimeve ekonomike globale, sfidave dhe pritshmërive për të ardhmen. Ministri Malaj zhvilloi një sërë takimesh me drejtues të lartë të FMN dhe BB, ku bëri një prezantim të treguesve kryesorë makroekonomikë në vendin tonë dhe

pritshmërive për të ardhmen, ndërsa shprehu angazhimin e plotë të Ministrisë së Financave për të vijuar konsolidimin fiskal, uljen e borxhit publik dhe zbatimin e reformave të nevojshme për të siguruar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë së vendit. Gjithashtu, z. Malaj u takua edhe me përfaqësues të disa institucioneve bankare ndërkombëtare, si JP Morgan, dhe agjencive vlerësuese Moody's dhe Standard& Poor's, ku u diskutua mbi progresin ekonomik të vendit tonë dhe reformat që po ndërmerren, veçanërisht sa i takon mirëmenaxhimit të borxhit, që janë një tregues i besimit gjithnjë e në rritje të investitorëve të huaj ndaj Shqipërisë.

► LEXO MË SHUMË

MOODY'S RIKONFIRMON VLERËSIMIN E SHQIPËRISË NË "BA3" ME PERSPEKTIVË "TË QËNDRUESHME"

Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kreditit Moody's Ratings ka rikonfirmuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në "Ba3" me perspektivë "të qëndrueshme". Moody's thekson se stabiliteti makroekonomik u ruajt gjatë tri goditjeve të mëdha që prekën ekonominë shqiptare, siç ishte tërmeti, pandemia dhe kriza energjetike evropiane, si dhe vlerëson qëndrueshmërinë, por edhe aftësinë për rimëkëmbjen e shpejtë. Agjencia nënvizon gjithashtu se perspektiva afatmesme e rritjes ekonomike do të

mbetet e qëndrueshme. Në aspektin fiskal, Moody's vlerëson trendin pozitiv të borxhit publik që ka rifilluar rënien që prej vitit 2022, pas tre goditjeve të mëdha. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së ra në 54.2% në vitin 2024 nga piku prej 74.1% në vitin 2021. Agjencia parashikon që borxhi publik të arrijë në 53.5% të PBB-së në vitin 2026, e mbështetur nga rritja e fortë ekonomike dhe suficitit primar fiskal. Agjencia vlerëson se autoritetet pritet të respektojnë rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit, për garantimin e mbajtjes së një bilanci primar të paktën të balancuar, si dhe uljen e raportit të borxhit të përgjithshëm të qeverisë ndaj PBB-së çdo vit, derisa të arrijë 45%.

► LEXO MË SHUMË

MOODY'S
RIKONFIRMON VLERËSIMIN
E SHQIPËRISË NË "BA3"
ME PERSPEKTIVË
"TË QËNDRUESHME"



MINISTRIA E FINANCAVE PREZANTON KUADRIN MAKROEKONOMIK DHE POLITIKAT FISKALE, SHQIPËRIA 2030

Ministria e Financave organizoi aktivitetin për prezantimin e Kuadrit Makroekonomik dhe Politikat Fiskale, Shqipëria 2030, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama, Ministrit të Financave, z. Petrit Malaj, përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare, përfaqësues të shoqatave të biznesit, Administratën Tatimore dhe Doganore. Në fjalën e tij, Ministri i Financave theksoi fillimisht faktin se falë reformave që po ndërmerren, ekonomia e vendit tashmë ka hyrë në fazën e konsolidimit, rritjes së qëndrueshme dhe mundësive konkrete që përkthehen në rritje të mirëqenies. Ministri përmendi disa prej arritjeve të shënuara në dekadën e fundit dhe u shpreh se qëllimi ambicioz është që përmes kombinimit të politikave të shëndosha fiskale dhe monetare, reformave strukturore të thella dhe investimeve strategjike, ekonomia shqiptare të garantojë një trajektore të re zhvillimi të qëndrueshëm, duke siguruar: ruajtjen e stabilitetit makroekonomik; uljen e borxhin publik; si dhe ndërtimin e një sistem fiskal modern, transparent dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Europian.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ MERR PJESË NË AKTIVITETIN E NIVELIT TË LARTË "TURIZMI I QËNDRUESHËM PËR PUNËSIM, JETESË DHE RITJE TË QËNDRUESHME"



ndryshme, politikëbërës dhe drejtues ndërkombëtarë, pjesëmarrësit diskutuan mbi mënyrat se si vendet mund të

Ministri Malaj mori pjesë në aktivitetin e nivelit të lartë "Turizmi i Qëndrueshëm për Punësim, Jetesë dhe Zhvillim", në kuadër të Takimeve Vjetore 2025 të Grupit BB dhe FMN. Gjatë aktivitetit të zhvilluar me pjesëmarrjen e ministrave të financave nga vende të drejtues ndërkombëtarë,

shfrytëzojnë potencialin e turizmit, në veçanti atij kulturor dhe të natyrës për të krijuar më shumë vende pune, për të fuqizuar komunitetet, si dhe për të nxitur një rritje të qëndrueshme ekonomike. Gjatë bisedës në panel, me Drejtoreshën e Përkohshme Globale për Mjedisin në Bankën Botërore znj. Genevieve Connors, Ministri Malaj, nënvizoi rrugëtimin e Shqipërisë turistike gjatë viteve të fundit, si dhe transformimin, si një nga destinacionet më dinamike të Mesdheut. Ministri theksoi se turizmi në Shqipëri do të vijojë të jetë një kontribuues i rëndësishëm për ekonominë shqiptare, ndërsa vizioni i qeverisë "Shqipëria 2030" do të mundësojë pozicionimin e vendit, si një destinacion udhëheqës në Mesdhe, i turizmit të qëndrueshëm.

► LEXO MË SHUMË



AKTI NORMATIV PËR DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN 2025

Akti Normativ për disa ndryshime në Buxhetin e vitit 2025 erdhi si nevojë e reflektimit të ndryshimeve për fushat e përgjegjësive të disa ministrive të linjës, por edhe për të garantuar përdorimin sa më efikas të fondeve publike. Përmes këtij Akti Normativ parashikohet: Akomodimi i një volumi të përgjithshëm prej 21.8 miliardë lekë për shpenzime korente e kapitale, përmes rishpërndarjes së kursimeve dhe hapësirave të tjera fiskale, me fokus mbështetjen e prioritetëve të Qeverisë. Nga

këto, vetëm investimet me financim të brendshëm rriten në terma neto me 7.97 miliardë lekë, për të garantuar vijimin e projekteve të rëndësishme në infrastrukturë, dixhitalizim, etj.. Po ashtu, përmes Aktit Normativ mundësohet financimi shtesë për Bonusin e fundvitit për pensionistët prej 5.9 miliardë lekë, që e çon në 9.7 miliardë lekë fondin total të dedikuar në 2025 për këtë politikë dhe rritja me 12.1 miliardë lekë të të ardhurave të përgjithshme, nisur nga tejkalimi i të ardhurave tatimore, doganore, por edhe i atyre të kontributeve shoqërore.

► LEXO MË SHUMË

PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKE TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-SHTATOR 2025

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Shtator 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Shtator 2025, arritën në rreth 562.5 miliardë lekë, një realizim në masën 101 % të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën

periudhë të një viti më parë, u mbledhën rreth 33.6 miliardë lekë më shumë ose 6.4 % më shumë. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 9 mujore të vitit 2025, arritën në rreth 515.5 miliardë lekë me një realizim në masën 95.7% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ky zë ka rezultuar 12.2% më i lartë ose rreth 55.9 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 9 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 62.5% e planit vjetor sipas



Buxhetit Fillestar dhe 62.4% e planit vjetor sipas Aktit Normativ Nr. 6 datë 11.06.2025 (AN nr.6).

► LEXO MË SHUMË



PROJEKTILIGJI "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË BANESAVE NGA TËRMETET", ZHVILLOHET TAKIMI KONSULTATIV ME GRUPET E INTERESIT

Ministria e Financave zhvilloi një takim konsultativ me grupe të ndryshme të interesit mbi projektligjin "Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet". Takimi u drejtua nga Ministri i Financave, i cili vlerësoi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të projektligjit dhe nënvizoi faktin se drafti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e Bankës Botërore. Ministri Malaj solli në vëmendje ndikimin e madh që pati për qytetarët shqiptarë dhe ekonominë në tërësi tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019, me një kosto të drejtpërdrejtë në

taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", llogaritjen e taksës mbi ndërtesën dhe pagesën e saj". Takimet konsultative u zhvilluan me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Dhomat e Tregtisë dhe shoqatat e biznesit, si dhe me përfaqësues të kompanive që operojnë në tregun e pasurive të paluajtshme. Ministri Malaj vlerësoi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të këtyre nismave ligjore dhe theksoi nevojën e dialogut me palët e interesuara, në mënyrë që të ketë një

rreth 7.5% të Produktit të Brendshëm Bruto. Ndonëse tërmetet janë fatkeqësi natyrore që nuk mund të parashikohen, tha z. Malaj, është e rëndësishme marrja e masave për të reduktuar sa më shumë të jetë e mundur efektet, e sidomos ato që sjellin ndikim në ekonomi. Ministri i Financave shprehu besimin se me zbatimin e ligjit, mbulimi efektiv i sigurimit do të rritet gradualisht ndër vite, si dhe do të përmirësohet ndjeshëm sistemi i menaxhimit të riskut në Shqipëri, duke krijuar kështu një mbrojtje financiare më të qëndrueshme.

► LEXO MË SHUMË



grupet e interesit për konsultimin publik të projektligjit "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme" dhe projektvendimit "Për miratimin e metodologjisë, rregullave dhe procedurave për përcaktimin e vlerës së

MINISTRIA E FINANCAVE ZHVILLOI TAKIME KONSULTATIVE ME GRUPET E INTERESIT PËR RIVLERËSIMIN DHE ÇMIMET E REFERENCAVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME

Nën drejtimin e Ministrit Petrit Malaj, u zhvilluan disa takime me

taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", llogaritjen e taksës mbi ndërtesën dhe pagesën e saj". Takimet konsultative u zhvilluan me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Dhomat e Tregtisë dhe shoqatat e biznesit, si dhe me përfaqësues të kompanive që operojnë në tregun e pasurive të paluajtshme. Ministri Malaj vlerësoi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të këtyre nismave ligjore dhe theksoi nevojën e dialogut me palët e interesuara, në mënyrë që të ketë një

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI PETRIT MALAJ TAKOHET ME NËNSEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA Z.HAOLIANG XU

Ministri i Financave priti në një takim Nënsekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (United Nations) dhe Administratorin në Detyrë të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) z.Haoliang Xu. Gjatë këtij takimi, Ministri Malaj ndau me z. Xu treguesit kryesorë të ekonomisë shqiptare dhe reformat që po ndërmerren për të garantuar ecurinë e qëndrueshme, mirëmenaxhimin e

financave publike, si dhe politikat për uljen e vazhdueshme të borxhit publik. Shqipëria është e angazhuar për të garantuar nxitjen e politikave në përmbushje të agjendës së Kombeve të Bashkuara, që kanë si synim arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Nga ana e tij z. Xu theksoi gatishmërinë e UNDP për të mbështetur forcimin e financave publike, koordinimin e politikave dhe menaxhimin e riskut, përfshirë mundësinë e angazhimit përmes Instrumentit të Sigurimeve dhe Financimit të Riskut, për të nxitur rritjen e qëndrueshme të Shqipërisë.

► LEXO MË SHUMË



MINISTRI I FINANCAVE TAKOHET ME DREJTORESHËN E PËRGJITHSHME TË KOMANDUAR TË ZYRËS EUROPIANE KUNDËR MASHTRIMIT/OLAF

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim me Drejtoreshën e Përgjithshme të Komanduar të Zyrës Europiane Kundër Mashtrimit/OLAF, znj. Salla Saastamoinen, në kuadër të Seminarit AFCOS 2025, i cili këtë vit organizohet në Tiranë. Gjatë këtij takimi, z. Malaj shprehu angazhimin e palëkundur të qeverisë shqiptare, në kuadër edhe të zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit

2025-2030, si dhe të masave që po ndërmerren për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe që ka në fokus qasjen, që Shqipëria ka për sigurimin e administrimit efektiv të fondeve të BE-së gjatë periudhës së paraanëtarësimit. Strategjia është në përputhje me direktivat e BE-së dhe me objektivat kombëtare, gjë e cila krijon bazat në luftën kundër parregullsisë dhe mashtrimeve. Nga ana e saj, znj. Saastamoinen vlerësoi bashkëpunimin me Shërbimin e Koordinimit Kundër Mashtrimit/ AFCOS që vepron si pika kryesore e kontaktit e Shqipërisë me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit, OLAF, si dhe progresin e bërë në zbatimin e praktikave më të mira europiane kundër mashtrimit financiar.

► LEXO MË SHUMË

NËNShKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MES DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE DHE AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

Në ambientet e Ministrisë së Financave, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Marrëveshja u firmos nga Drejtori i Shqiptarëve të Doganave, z. Genti Gazheli dhe Drejtori i AKSHE-së, z. Andrea Shllaku, në prani të Ministrit të Financave, z. Petrit Malaj dhe Ministrit të Mbrojtjes, z. Pirro Vengu. Ky akt institucional ka si qëllim forcimin e

bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për lehtësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta në fushën e kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe atyre ushtarake. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen të zhvillojnë një platformë efektive komunikimi dhe shkëmbimi informacioni, si dhe të ofrojnë asistencë teknike gjatë identifikimit dhe klasifikimit të mallrave që hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 46/2018 dhe Kodit Doganor.

► LEXO MË SHUMË

